



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27.12.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1638_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 7 pika 7.2, Nenit 26, paragrafi 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 22 paragrafi 7 dhe Nenit 23 paragrafi 5, dhe paragrafi 9, pikat 9.3, 9.13, 9.15 dhe 9.16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 2.1.2 paragrafi (a) pika (x), dhe Nenit 11.5.2 të Rregullave të Tregut, të miratuara me Vendimin e ZRRE nr. V_1066_2018 të datës 30/10/2018;
- Memorandumin e Mirëkuptimi (MeM) për të koordinuar aktivitete për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë, si hap i parë për integritet rajonale të tregut të energjisë, nënshkruar në prill 2014 nga Ministrinë përkatëse të Kosovës dhe Shqipërisë;
- Memorandumin e Mirëkuptimit të Ballkanit Perendimor 6, të nënshkruar në Vjenë me 27 prill 2016 për Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike, nënshkruar nga Shqipëria dhe që Kosova ka shprehur gadishmëri për ta zbatuar;
- Memorandumin e Mirëkuptimit për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Bursës së Energjisë Elektrike në nëntor 2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës;
- Marrëveshjes Kornizë për Bashkimin e Tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të nënshkruar me 21 tetor 2021, ndërmjet ZRRE, ERE, KOSTT dhe OST;
- Themelimin e ALPEX sh.a, në të cilën KOSTT është aksionar dhe me të drejta të plota;
- Regjistrimin e Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Degës në Kosovë;
- Vendimin e ZRRE nr.1332_2020, për Arovim në parim të kërkesës së OT/KOSTT SH.A për transferim e disa të drejtave dhe përgjegjësi që kanë të bëjnë me organizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës, tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX).
- Marrëveshjen për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a (KOSTT) tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar, të nënshkruar me 16 dhjetor 2022;
- Vendimit të ZRRE nr. V_1637_2022 për Arovimin e transferit të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar nga



Operatori i Tregut/KOSTT sh.a tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), i datës 27.12.2022;

- Kërkesës për aprovim të Rregullave dhe Procedurave të Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), të bërë nga Drejtuesi i Degës në Kosovë të datës 17.11.2022.

në seancën e përbashkët publike me Bordin e Entit Regullator të Energjisë (ERE) të Republikës së Shqipërisë të mbajtur me datë 27.12.2022, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** Rregullat dhe Procedurat (Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e tregimit si dhe Procedura e klerimit dhe shlyerjes) e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX).

ARSYETIM

- o Zyra e Regullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 17.11.2022 ka pranuar Kërkesën për aprovim të Rregullave dhe Procedurave të Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), të bërë nga Drejtuesi i Degës në Kosovë.
- o Kërkesa e cekur më lartë ka ardhur si rezultat i procesit për krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë elektrike mes Kosovës dhe Shqipërisë, e të cilit proces i kanë parapri edhe Marrëveshjet si në vijim:
 - Memorandumin e Mirëkuptimi (MeM) për të koordinuar aktivitetet për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë, si hap i parë për integrimi rajonale të tregut të energjisë, nënshkruar në prill 2014 nga Ministritë përkatëse të Kosovës dhe Shqipërisë;
 - Memorandumin e Mirëkuptimit të Ballkanit Perëndimor 6, të nënshkruar në Vjenë me 27 prill 2016 për Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike, nënshkruar nga Shqipëria dhe që Kosova ka shprehur gatishmëri për ta zbatuar;
 - Memorandumin e Mirëkuptimit për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Bursës së Energjisë Elektrike, nënshkruar në nëntor 2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës;
 - Marrëveshje Kornizë për Bashkimin e Tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të nënshkruar me 21 tetor 2021, ndërmjet ZRRE, ERE, KOSTT dhe OST;
- o Në mënyrë që Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), të operoj në mënyrë transparente ndaj të gjithë pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike, është e domosdoshme të krijohet dhe aprovohet Rregullat e ALPEX. Për këtë qëllim janë hartuar Kushtet e Përgjithshme; Procedurën e tregimit; Procedurën e klerimit dhe shlyerjes dhe Përkufizimet.
- o Rregullat dhe Procedurat e cekura më lartë (Rregullat e ALPEX) fillimisht janë vendosur në Konsultim Publik nga Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), dhe



ju janë dërguar e-mail me dokumentet e bashkangjitura përkatëse tek të gjitha palët legjitime tregtare, për komente eventuale. Gjithashtu Rregullat dhe Procedurat e e cekura më lartë janë vendosur në Konsultim Publik edhe nga ZRRE.

- o Komente e pranuar janë trajtuar në dy takime të përbashkëta (njëri i drejtpërdrejtë me prezencën e dy Bordeve të ERE dhe ZRRE), dhe takim tjetër konsultativ është organizuar nga ERE ndërsa ZRRE ka marr pjesë përmes platformës elektronike.
- o ZRRE, pas analizimit dhe vlerësimit të Kërkesës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), si dhe vlerësimit të Marrëveshjeve dhe tërë këtij procesi të përshkruar më lartë, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, në mbledhjen e përbashkët publike të Bordit të ZRRE dhe Bordit të ERE të mbajtur me datë 27.12.2022, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

OT/KOSTT SH.A

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX).

Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Pejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar